

## MBRESA UDHËTIMI NGA VENDBANIMET ARBËRESHE TË KALABRISË (1)

## Shpirti i Arbrit rron!

Mustafa IBRAHIMI

**S**tudentet e vitit të dytë dhe të tretë të **Katedrës së Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe** të Fakultetit Pedagogjik të **UEJL**, prej **1-10 maj 2006** realizuan vizitë njëjavore tek **Arbëreshët e Kalabrisë**. Mikpritja e ngrohtë vëllazërore arbëreshe, dashuria e tyre e zjarrtë për vendin nga i kishin rrënjët, dashuria e tyre për shqiptarët e këndej detit, sofrat e tyre me bukë, kripë, e zemër dhe lotët kur këndohej himni arbëresh "**Moj e bukura More**", ishin karakteristikë e kësaj atmosfere që u krijua me rastin e qëndrimit të këtij delegacioni në tokën e atdheut të dytë të arbëreshëve, në Kalabri. Kjo ishte një vizitë historike, do të thoshin arbëreshët. Ishte kështu se përherë të parë, pas shumë shekujsh të ndarjes së kësaj pjese të kombit nga trunghi i vet, një delegacion me studentë të një Katedre të Albanologjisë me pedagogët e tyre e bënë këtë vizitë me karakter mësimor e shkencor.

E tërë kjo u realizua falë këmbëngulësisë së profesorëve të kësaj Katedre për ta realizuar këtë projekt, gatishmërisë së Dekanatit të Fakultetit

Pedagogjik për ndihmesën e vet, angazhimit të Rektorit që me këtë vizitë të nisë bashkëpunimi mes UEJL-it dhe atij të Kozencës, dëshirës së kamotshme të studentëve, dhe mbi të gjitha që vlen të theksohet, kjo vizitë u realizua falë Agjencisë Turistike "**Habib Tours**" nga **Gostivari** me pronarin **Zarif Bajrami**, që na mundësoi udhëtimin falas me autobus modern për dhjetë ditë me vozitësin që meriton çdo lëvdatë.

Programi i përbashkët i hartuar nga Katedra e Albanologjisë së UEJL dhe Katedra e Albanologjisë së Universitetit të Kozencës të udhëhequr nga nikoqiri ynë kryesor prof. **Françesko Altimari** u realizua në tërësi.

Delegacioni ishte i përqendruar në Katedrën e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe të **Universitetit të Kozencës** dhe i vendosur në fshatin e **Zef Serembes, Strigari**. Gjatë këtij qëndrimi u vizituan disa katunde arbëreshe nga të cilat në këtë rast po përmendim: **Maqin**, vendlindjen e **De Radës** së madh, katundin **Mbusat**, vendlindjen e **Jul Varibobës**, Katundin **Strigari të Zef Serembes, Çifti, Shën Dhimitër Koronën, Shën Benedeti Ulanon, Frashnita, Shën Sofi** etj.



*Dr. Vebi Bexheti, dr. Françesko Altimari, dr. Mustafa Ibrahim dhe dr. Ejup Ajdini në Kozencë*

### Me shefin e Katedrës z. Altimari në Kozencë

Sapo vendosemi në fshatin **Strigari**, sipas planprogramit duhej menjëherë të takohemi me profesorët dhe studentët e Katedrës së Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe në Universitetin e Kalabrisë në Kozencë. Mikpritja e ngrohtë dhe dashuria vëllazërore e nikoqirëve bënë që ne ta harrojmë lodhjen dhe të ndjehemi si në shtëpi. Pasi na ndanë materiale dhe libra të botuara viteve të fundit, z. Altimari me kolegët e tij bënë një prezantim mjaft të gjërë mbi projektet dhe aktivitetet aktuale.

Për këtë z. Altimari thotë: "*Në sja të punës së vyer didaktike e shkencore të nisur nga mjeshtri ynë i paharruar, i ndjeri prof. Françesko Solano, i cili praktikisht e themeloi katedrën tonë më 1975, është krijuar në Universitetin e Kalabrisë një qendër e rëndësishme albanologjike dhe një qendër dokumentacioni shkencor për bashkësitë e shumta arbëreshe të kësaj krahine të Jugut të Italisë, të cilat përfaqësojnë pothuajse dy të tretat e popullsisë së minoritetit arbëresh që sot jeton në Itali: në tri provinca të Kalabrisë, domethënë në provincat e Kozencës, të*



*Profesorët dhe studentët e dy katedrave albanologjike të UEJL-it dhe Universitetit të Kalabrisë në amfiteatrin e madh - Kozencë*



Prof. F. Altimari dhe prof. G. Bellushi duke prezantuar projektet

Katanxarit dhe të Kutronit, gjenden sot 33 nga 50 bashkësitë arbërishtfolëse të Italisë.

Vetëm në provincën e Kozencës ndodhet gjysma e bashkësive arbëreshe ende të gjalla sot nga ana gjuhësore (25 mbi 50). Kjo lidhje e ngushtë me trevat arbërishtfolëse, që karakterizojnë historikisht edhe katedrën tjetër simotër albanologjike të Universitetit të Palermos e që i dallon këto dy katedra nga katedrat e tjera albanologjike të Italisë, gjeografikisht të shkëputura nga konteksti arbërishtfolës, përfaqëson një ndër tiparet që na shpjegon vetvetiu edhe drejtimit që mori shkenca albanistike në këto dy qendra studimore dhe kërkimore.

Në të vërtetë, mund të themi se në kushtet e reja historike këto dy katedra po vazhdojnë veprimtarinë arsimore të nisur në shekujt e mëparshëm nga dy kolegjet fetare dhe qendra të rëndësishme kulturore, të përfaqësuara nga Kolegji arbëresh "Corsini", pastaj "Corsini-S. Adriano" në Kalabri (me seli më parë në Shën Benedhit dhe pastaj në Shën Mitër), dhe nga Seminari arbëresh i Palermos në Sicili.

Por, këto dy qendra universitare të Kozencës e të Palermos, të inkuadruara njëkohësisht në botën kulturore arbëreshe dhe në botën akademike, kombëtare e ndërkombëtare, kanë mundësinë ta lidhin këtë veprimtari me zhvillimet e shkencës gjuhësore dhe letrare moderne, duke u përqendruar sipas orientimit akademik brenda lëndës së përbashkët "Gjuhë dhe letërsi shqipe" (italisht "Lingua e letteratura albanese"), qoftë në fushën gjuhësore e dialektologjike, qoftë në fushën e shkencës së letërsisë, në një

perspektivë historiografike, kritike e filologjike. Në universitetin tonë, por pjesërisht edhe gjetkë, kjo u nda nga "sht-rati" i saj i përbashkët i "Gjuhës dhe i Letërsisë shqipe" në disa

degë më specifike, siç janë "Gjuha shqipe", "Letërsia shqipe", "Dialektet arbëreshe të Italisë së Jugut" dhe "Filologjia shqiptare".

## Veprimtaria shkencore e Katedrës Albanologjike

Duke u ndalur këtu mbi veprimtarinë shkencore të zhvilluar në këta tridhjetë vjet nga katedra jonë, mund të themi se ajo u drejtua kryesisht në dy fusha: a) në fushën letrare: në vjeljen e dorëshkrimeve dhe në analizën e në përpunimin e teksteve, edhe me sistemet informatike; b) në fushën gjuhësore: në vjeljen në terren të të dhënave dialektologjike. Kanë qenë, pra, filologjia dhe dialektologjia, për arsyt e lartpërmendura, fushat e privilejuara të punës kërkimore të kryer nga pedagogët, nga kërkuesit, nga bashkëpunëtorët shkencorë dhe nga studentët e katedrës sonë. Në të vërtetë, për shkak të mungesës së kuadrove të reja kërkimore - në fillim, për afro 15 vjet, katedra jonë kishte në organikën e vet vetëm një

pedagog e një lektor - bashkëpunimi i studentëve ka qenë vendimtar për t'i arritur objektivat e vendosur edhe për kërkimet në terren.

Në fazën e parë, që përfshin periudhën 1975-1990 (siç mund të verifikohet nga vetë lista e temave të disertacionit që janë diskutuar në atë periudhë), tezat me karakter gjuhësor përqendroheshin - me ndonjë përjashtim - kryesisht në përkrahimin e përgjithshëm të dialekteve arbëreshe, por brenda monografish ku mbledheshin material nga letërsia gojore e material dialektologjik. Natyrisht ishte e domosdoshme që këto përshkrime, të cilat ishin shumë herë të parat që po bëheshin për këto bashkësi, të përfshinin sa më shumë material (etnografik, letrar, gjuhësor etj.), për të ruajtur kujtesën historike dhe shenjat ende të gjalla të kulturës shpirtërore e materiale arbëreshe, që po humbiste nën trysninë e pashmangshme - atëherë kështu na dukej të gjithëve - të modernitetit e të modelit asimilues të shoqërisë italiane.

Qysh prej viteve '90 dhe pas hapjes së kursit të Dialekteve arbëreshe (1980), kërkimet e katedrës sonë filluan të përqendroheshin më shumë në vjeljen sistematike të leksikut dialektor, duke u mbështetur, nga njëra anë, në corpora tekstesh 'të rindërtuara' nga ana filologjike e të përmbledhura në dorëshkrime të zbuluara në revista italiane të shekullit XIX; nga ana tjetër, në punën metodike kërkimore të studentëve tanë, që filluan të mbledhnin leksikon e përgjithshëm dhe leksikon e veçantë duke u mbështetur në pyetësorë të shfrytëzuar për atlaset, si fjala vjen ALE (Atlas Linguarum Europae), ALI (Atlante



Profesorët dhe studentët e UEJL-it, duke ndjekur prezantimin

*Linguistico Italiano*), ALSh (Atlasi Linguistik Shqiptar). Për ALE-n kemi përdorur të dy pyetësorët - ALE 1 dhe ALE 2 - që përfshijnë përkatësisht 546 dhe 864 pyetje, për ALI-n një version integral me 7659 pyetje dhe një version të reduktuar e të adoptuar me 1646 pyetje, ndërsa për ALSh-në kemi përdorur pyetësorin e Eqrem Çabej-it me 2579 pyetje etj".

Nga prezantimi aq i përpiktë, ishim të sigurt se me mjetet e reja teknologjike që kishin në dispozicion mund të krijonin një bazë të dhënash leksikore të mëdha e të përditësuar. Për këtë profesor **Gjovani Bellushi**, profesor në lëndën e dialektologjisë thotë: "për sa na përket neve si arbëreshë është kusht i domosdoshëm për të konkretizuar projektin modular të



**Në Bibliotekën e Universitetit të Kalabrisë në Kozencë**

një Fjalor të Madh të Arbërishtes. Këtë fjalor ne si albanologë në Itali e kemi përparësi shkencore në vitet e ardhshme, për të përballuar edhe sfidën e madhe që na del pas miratimit të ligjeve në favor të minoritetit tonë, duke i vënë në dispozicion bashkësisë arbëreshe pasurinë e madhe gjuhësore që trashëguam e që pret të njihet e të vlerësohet edhe nga ana didaktike, si dhe të vihet në dispozicion të njerëzve tanë dhe të shkencës". Më tutje ai përmendi dialektologun danez Gangale, i cili kishte vjelë material nga zona e Kalabrisë, i cili ishte mbështetur kryesisht në alfabetin e De Radës."

Më pas me ligjëratat e tyre u prezantuan edhe pedagogët e tjerë si **Andon Berisha** në fushën e letërsisë si dhe **Franko Jusi**, i cili ishte përgjegjës për Qendrën e Informatikës gjuhësore, ku bën pjesë vjelja e leksikut dhe teksteve të vjetra letrare në formë elektronike.

Nga ta u njoftuam se në Katedër

kishte rreth 90 punime diplomash (përfshi këtu tema edhe nga dialektologjia dhe leksikologjia. Kurse biblioteka e Universitetit të Kozencës (më e madhja në Italinë Jugore) vetëm nga fusha e Albanologjisë posedonte 4 fonde të posaçme.

## Takimi me prorektorin e Universitetit të Kalabrisë

Profesor **Altimari**, me përpikmëri të jashtëzakonshme e kishte organizuar prezencën tonë atje. Ditën e dytë të qëndrimit tonë atje, kishte organizuar takim edhe me rektorin e Universitetit. Mirëpo për shkak të angazhimeve të zakonata, na pranoi prorektori. Pas një pritjeje të shkurtër ai mbrini me disa broshura dhe katalogë të UEJL-it. Pasi u prezantua na njoftoi se ishte mirë i informuar për Universitetin tonë.

Universiteti i Kalabrisë këtu në Kozencë u themelua në vitin **1973** dhe në gjirin e saj ka **35 mijë** studentë, vetëm **4000 studentë** banojnë në kampus. Vetë Universiteti është i gjatë **2,5 km**. Në të gjitha fakultetet janë të themeluara Fushat kërkimore. Por gjithçka është e lidhur me Qendrën Informatike e cila është e teknologjisë së lartë, kuptohet nuk mungon edhe bashkëpunimi ndërkomëtar, ku do të ishte me rëndësi edhe kycja juaj në këto projekte. Në këtë drejtim ka bërë shumë Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe nën udhëheqjen e prof. Altimarit.

## Busti i Skënderbeut dhe dëshmorët arbëresh

Pasi mbaruam takimet dyditore në Universitetin e Kalabrisë, nikoqirët na organizuan një shëtitje në pjesën e vjetër të qytetit të Kozencës. Prof. Altimari na njoftoi se arbëreshët kanë luajtur një rol shumë të madh në historinë e Italisë, sidomos në kohën e **Garibaldit**. Andaj edhe kanë një vlerë të veçantë për Italinë. Para së gjithash sepse: kontribuan për bashkimin e Italisë, janë shembull për komunitetet tjera, përforcuan kulturën me popujt tjerë dhe në përgjithësi vlerësohet lartë kultura arbëreshe.

Këtë e vërejtëm edhe vetë. Në hyrje të pjesës së vjetër të qytetit gjendej **Kisha**



**Busti i Skënderbeut në Kozencë**

**arbëreshe**, ku meshat kryheshin në gjuhën arbëreshe, kurse përballë saj gjendej **busti i Skënderbeut** dhe **rruga** me të njëjtin emër. Kuptohet studentët nuk e lëshuan këtë rast për t'u fotografuar para kësaj figure historike shqiptare, siç bëjnë edhe ne.

Duke hipur përjetë qytetit të vjetër (Çarshia e vjetër-siç do të kishim thënë ne), u habitëm se kjo pjesë një kohë shumë të gjatë ka qenë e braktisur nga pronarët e dyqaneve sepse rëndësi i kanë dhënë qytetit modern. Por me ndihmën e Bashkimit Evropian, kësaj pjese të vjetër të qytetit i jepej shkëlqimi i vjetër, gryhej asfaltimi dhe në vend të tij përsëri shtrohej kallëdmaja prej guri duke u dhënë rrugicave pamjen autentike të vjetër. Në fund gjendej një përmendore. Aty gjendeshin dëshmorët që luftuan për bashkimin e Italisë, në anën e Garibaldit. U habitëm se mbi **80% të dëshmorëve ishin arbëresh**. E kishim të qartë se pse italianët i vlerësojnë shumë arbëreshët dhe kulturën e tyre.



**Dëshmorët arbëresh që dhanë jetën në kohën e Garibaldit në Kozencë**



Autobusi Skura në linjën Kozencë - katunde arbëreshe

## Autobusat me shkrimin "Scura" dhe shqiponjën dykrenore në mes

Duke u kthyer për në hotelin në fshatin Strigari, tashmë të rraskapitur dhe të lodhur nga takimet gjatë ditës dhe shëtitjet në këmbë nëpër qytetin e vjetër të Kozencës, kënaqeshim me peizazhet

edhe mbiemri **Scurra (Skura)**". Deri sa i tregonte këto të dhëna, befaz para nesh kaloi një autobus, në mes i shkruar pikërisht me këtë emër, kurse mbi të e vizatuar **shqiponja dykrenore**. Kjo pak na habiti, sepse sa më shumë u afroreshim katundeve arbëreshe, këta autobusë sikur shpeshtoheshin. "Po tha, Vinçenco, këta autobusë i takojnë kompanisë ku si



H.Xhaferi, F.Altimari dhe autori para Kishës Arbëreshe në Kozencë

e bukura. Shoferi i autobusit "Habib Turs", vazhdimisht na lëshonte këngë arbëreshe, ashtu që udhëtimi komplet ishte autentik arbëresh. Nikoqiri **Vinçenco Bruno**, me një shqipe të pastër orvatej të na shpjegoj diçka nga historiku i kësaj krahine. Sapo mendonte se është interesante për të theksuar, ai ia niste. "Banorët e Strigarit besojnë se prejardhjen e tyre e kanë nga Struga, në fakt vetë emri **Strigari** do të thotë në arbërisht **Struga**. Me këtë emër përputhet

pronarë është **familja Skura**. Ata kanë me dhjetëra autobusë të tillë, kryesisht mbajnë linjën Kozencë dhe katundet arbëreshe, madje kanë edhe linjë për në Gjermani e vise të tjera jashtë Italisë. Janë të vendosur në qytetin **Corigliano Calabro**, qytet ku **Jeronim de Rada** e hapi shkollën e parë arbëreshe. Kjo qytezë ka edhe një të folme karakteristike". Ne nuk kishim kohë të ndalemi dhe të bisedojmë me vendasit në lidhje me

karakteristikat e të folmes së tyre, ndoshta do të gjenim tipare të njëjta me të folmen shqipe të Strugës!

Derisa udhëtimi vazhdonte, më fluturuan shumë mendime, çfarë do të ndodhte te ne me autobusin, nëse kishte të vizatuar shqiponjë!! Sigurisht së pari do t'ia kishin thyer xhamat e pastaj do ta kishin dënuar me vite!. Gjatë gjithë rrugës takojmë "agrumishte" (siç i thuan arbëreshët vendit të mbjellë me ullinj), pak para Strigarit. z.Vinçenco na njofton se në këtë fshat të vogël pa emër ka jetuar **familja Bua**. Kurse pak më tutje gjendet katundi **Kantinella**, i cili ka rrënjë të një qyteti të lashtë. Aty sot jetojnë shumë arbëresh të zbritur kruesisht nga fshatrat arbëreshe përreth".

Vinçencoja, edhe më tutje shpalos kujtime të vjetra arbërore, duke na kujtuar se "*shpirtëri i arbit rron*". "Provinca e Kozencës ka 25 fshatra, gjysma prej tyre janë fshatra arbëreshe. Vari i **nipit të Skënderbeut** gjendet pikërisht këtu në Kalabri". Më dukej se këtë e thoshte me krenari, por në atë moment në radio filloi kënga "*Oj e bukura More*" (himni i tyre), vërejtja se Vinçenco nuk kishte më forcë dhe ndjenja të flas, pashë vetëm do pika loti, që as që kujdesej t'i fshijë apo t'i fshih. Ishin ato lotët e mallëngjimit pesëshkullor. Në heshtje arritëm në fshatin Strigari. Në hyrje të fshatit në dygjuhë u paraqit mbishkrimi "*Mirë se erdhët në Strigar*".

(Vazhdon)

(Në numrin e ardhshëm : "**Rrugicat e heshtjes**" në Strigarin e Serembes)



MBRESA UDHËTIMI NGA VENDBANIMET ARBËRESHE TË KALABRISË (2)

# “Rrugicat e heshtjes” në Strigarin e Serembes!

Mustafa IBRAHIMI

**Nj**ja 60 kilometra larg kryeqendrës së **Kozencës**, në një lartësi mbidetare prej 407 m, duke kaluar një rrugë gjarpërore arritëm në fshatin **Strigari**. Katundi zgjerohet mbi një kodër të lartë, të veshur me vreshta, portokaj dhe limonë, me pamjen e detit Jon nga lindja. Është i vendosur në luginën e lumit Krati në brinjët e malit Serra Krista i Akres, i përket pakicës së ashtuquajtur piacë italisht -arbëreshe. Kufijtë e tij venë që nga lumi Sabatino, mbi kufinë e fshatit të Vakaricit, deri në përroin e Pisciacane, afër territorit të Kurlanës. Për pozicion gjeografik të tij, në mes të detit dhe të malit, ai gëzohet nga rrymat e detit dhe nga mbrojtja e maleve përreth duke paraqitur një klimë mjaft të butë, me dimra të buta dhe vera të ngrohta.

Tabelat ndër rrugë të urojnë në shqip “Mirë se na Erdhët”. Kjo të bën të ndihesh si në shtëpinë tënde. Para hyrjes në fshat, trafiku është i rregulluar me një unazë, kurse në mes saj **Monumenti i Punës (vepër e rejtareve të vendit, u përu-**

*“Shoh katundin, mallin tën,  
mall i fort që s’ka të thën”*

Z. Seremba

**rua më 1 Maj 2005**), prapa këtij monumenti **Harku i Paqes** dhe hoteli.

Pasi vendosemi në hotel, mikpritja e personelit në krye me **Kozmon**, i cili ishte dhëndër arbëresh ishte në nivel. Takimi me të prej fillimi deri në fund të qëndrimit tonë reflektoi tërë temperamentin italian, me shumë emocione, që për ne u shndërrua në një zbatimje dhe shoqërim të këndshëm. Udhëheqësi ynë z. **Vinçenco Bruno**, para se të na lë me shpresë se do të shihemi përsëri na njoftoi se informata më të hollësishme do të fitojmë në **Bashki**, që gjendet në qendër të fshatit.

Me të arritur atje vërejtëm se gjithçka ishte shkruar në dy gjuhë, edhe vetë objekti ku ishte ky institucion me dhjetë të punësuar mbante mbishkrimin edhe në shqip “Bashkia”, kurse para saj **busti i Zef Serembes**. Kryebashkiaku **Anton Mondera**, edhe pse ishte i zënë, në rrjedh ishin zgjedhjet për anëtarët e këshillit, na priti me zemërgjerësi dhe mikpritjen shqiptare. Siç e kishin zakon, na dhuruan gjithçka që kishin botuar deri



Pamje nga fshati Strigari



Monumenti i Punës ( vepër e rejtareve të vendit, u përuhua më 1 Maj 2005)

atëherë, libra, CD dhe broshura për fshatin. Midis tyre na dhuroi edhe DVD-në “*Dasma arbëreshe*” nga regjisori shqiptar **Lionel Konomi**. DVD-ja përfshinte ceremoninë e dasmës arbëreshe.

Më pas z. **Mondera** na njoftoi se f.Strigari ka: 658 banorë (324 meshkuj dhe 334 femra), me 293 familje. Sipas statistikave: Viti 1534: 186 banorë - fillim i shekullit XVII: ~300; 1723: ~500; 1871: 770 - 1901: 715 - 1911: 868 - 1921: 678 - 1931: 826 - 1971: 1035 - 1991: 780 - 2001: 702. Për bashkinë e Strigarit regjistrimi i 1991 dha një popullsi të barabartë me 780 banorë, që në regjistrimin e 2001 u rregjuan në 702. Prandaj në dhjetëvjetëshin ndodhi një ndryshim për qind i barabartë me -10,00%.

Veprimtaria kryesore nga shekuj, është bujqësia: burim pune dhe fitimi për gjithë vitin. Të famshme lërimete ullishtave, agrumishtave dhe vreshtave.

Në fshat mbahet edhe pazari i mujshëm, gjegjësisht ditë pazari është çdo e dyta e diel. Ndërsa panairi vjetor mbahet prej 25-28 shtator. Nuk harroi të na tregojë se në fshat ekzistojnë rrjedha uji si: **Lumi i Madh, Mballasiu, Lumi i mesit (Mëxofti, siç i thonë vendasit)**. Mbiemra më të dendura në fshat janë: **Bua, Bafa, Montalto, Corino, Minshi, Sposato, Algieri, Buffone, Cofone, Gabriele**.



Profesorët, studentët dhe personaleni, para hotelit në fshatin Strigari ku ishim të vendosur

## Origjina dhe historia

Strigari u themelua në fund të 1400 nga të mërguarit shqiptarë që iknin nga dheu i atyre i shkëlur nga Turqët. Emigrimi më i madh që me vdekjen e kapedanit Gjergj Kastrioti Skënderbeg. Të mërguarta qenë sjellër nga disa familja, pikërisht tre, që tek dheu i tyre ishin në një gjedje të mirë shoqërore dhe ekonomike: "Strigàrët" (nga të cilët vjen pa dyshim toponomi me të cilin arbëreshët njohin këte vend). Këta u vendosën pikërisht pranë manastirit të Shën Kosmait dhe Shën Domianit.

## Strigari fshat i heshtjes!

Nga vetë të dhënat e kryebashkiakut u bindëm se fshati po zbrazej. Numri i të rinjve por edhe i të tjerëve ishte alarmues. **Vinçencoja** me dhembje të madhe na shpjegonte se rrugica kryesore e fshatit tashmë nga fshatarët quhej **"Rrugica e heshtjes"**. Edhe pse vërejmë shtëpi të mëdha dhe luksoze, ai na njofton se në të dyja anët e rrugës nuk ka më njerëz, pothuaj të gjithë janë shpërngulur, kryesisht në Italinë e Veriut, por një numër edhe në shtetet perëndimore dhe tejoqeanike. Këtu natën dhe ditën gjithmonë është në heshtje, nuk ka britma të fëmijëve".

Një fshatar, i cili ishte nisur për në punë, pasi u përshëndetëm në shqip, kuptohet edhe ai na ktheu u ndal të bisedojë, me një arbërishte të kuptueshme. **"Jam bujk dhe merremi me punët bujqësore. Kam pak tokë të mbjellur me ullinj. Të ardhurat janë minimale, është vështirë të mbijetosh me ato të holla, prandaj çdokush mendon të ik, për një jetë më të mirë"**.



Profesorët dhe studentët e UEJL-it, me arbëreshët e Strigarit para një shitore




**Në teatrin veror të Strigarit u zhvillua në 2003 (5-9 gusht) Festivali i dytë euromesdhetar i Muzikës dhe i Vallëzimit.**

## Kostumet arbëreshe të Strigarit

Kostumet që gratë arbëreshe kanë veshur deri para pak dhjetëvjetësh, sot përdoren vetëm në shfaqje kulturore e folkloristike e trashëgohen me kujdes të madh nga nënë në bijë, meqenëse përbëjnë një kryevepër të vërtetë zejtarie. I prodhuar me stofa të begatshëm veçanërisht luksozë, me përbarime e dekore edhe prej ari të kulluar, kostumi femëror ceremonial konsiderohet një ndër kostumet popullore evropiane më të bukura.

Sipas situatave në të cilat vishet, kostumi dallohet në kostum ceremonial, gjysmëfeste, të përditshëm dhe zie.

Kostumi ceremonial përbëhet nga dy funde prej mëndafshi, me të njëjtën formë, të veshura njëra mbi tjetrën, të palosura hollë, me ngjyra të ndezura e të kundërta (si mavia me të kuq të amarant ose e gjelbra me ngjyrën manushaqe), me në skaj një bordurë stofi të petëzuar në arë, të lartë 15-25 cm, sipas mundësive ekonomike të familjeve.



**Veshje arbëreshe nga Strigari**

## Situata gjuhësore e qendrave arbëreshe

Duke pushuar në oborrin e hotelit, u ofruan disa të rinj arbëresh. Kontakti i parë me ta ishte i vështirë, sepse aspak nuk na kuptonin, duhej shumë mund që të përkujtoheshin të flasin arbërisht. Megjithatë me një durim arrinim t'i bindim të flasin arbërisht. Por, zotërimi i arbërishtes nga këta të rinj ishte alarmues, e folmja e tyre ishte plot italianizma dhe fjalë krahinore. Ja se çfarë na deklaroi profesor i lësëndës së dialektologjisë në Katedrën e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe në Universitetin e Kalabrisë, **Gjovano Bellushi**, për çështjen se si paraqitet sot situata gjuhësore e qendrave ku flitet arbërishtja? **"Situata gjuhësore e qendrave arbëreshe po ndryshon në krahasim me 20 vjet më parë dhe mund ta konsiderojmë në një fazë vuajtjeje, sepse elementi gjuhësor arbëresh dobësohet dhe po i lë vend elementit italian. Nuk është një përshlyetje, por një konstataim objektiv i shkaktuar nga ndryshimi i marrëdhënieve shoqërore dhe nga zhvillimi i shpejtë i komunikimeve të përgjithshme. Nga njëra anë shkollimi i përgjithshëm pas viteve '60 e këndeje, por shkollim vetëm në gjuhën dhe kulturën italiane duke mohuar kulturën minoritare arbëreshe, nga ana tjetër ndikimi i mjeteve të informacionit masiv po shkaktojnë braktisjen e gjuhës lokale arbëreshe prej të rinjve. Transmetimi, trashëgimia e gjuhës dhe e kulturës arbëreshe nëpërmjet vetëm rrugës gojore nuk mjafton më, has vështirësi dhe nuk ka sukses"**.

Megjithatë ne vërejtëm se kishte disponim të madh të të rinjtë për ta mësuar dhe përdorur arbërishten. Kjo falë sporteveleve gjuhësore të shpërndarë nëpër fshatrat arbëreshe.



**Motoja e arbëreshëve e për krahur nga Qeveria italiane dhe Bashkësia Evropiane**

### Sportelet gjuhësore në fshatrat arbëreshe

Një reze shprese vjen nga pranimi i ligjit për mbrojtjen e *pakicave gjuhësore historike* nga ana e **Parlamentit italian (ligji 482/99)** që po fillon të zbatohet edhe në fshatrat arbëreshe".

Me këtë edhe vetë u bindëm, në çdo fshat arbëresh, në kuadër të Bashkisë ishin të hapur **sportelet gjuhësore** ku ishin të punësuar dy arbëresh, kryesisht që kishin mbaruar Gjuhën dhe Letërsinë Shqipe. Përshtypja jonë ishte se e njihnin shumë mirë gjuhën letrare, kryesisht sepse kishin ndjekur seminarin në Prishtinë. Ata kishin edhe moton e tyre "**Pse jo arbërisht?**"

### Shkaqet për dobësimin e gjuhës arbëreshe!

Një prej tyre na deklaroi: "*Fenomenet që shkaktojnë dobësimin e gjuhës arbëreshe mund t'i përcaktojmë në tri pika: 1) kalimi më i lehtë në gjuhën italiane edhe në të folmen e përditshme, sidomos nga të rinjtë; 2) shtimi i leksikut italian në të folmet arbëreshe, si edhe i trajtave gjuhësive të përziera me italishten, krejt të panevojshme; 3) dobësimi i qëndrësës së strukturës gramatikore.*"

Por një gjë të bën krenar, kur je ndër ta flitet arbërisht, përshëndeten arbërisht, në kishë flasin arbërisht, në restorantet e tyre menytë janë në italisht dhe arbërisht, gjuhë e trashëguar dhe e ruajtur brez pas brezi për më shumë se 500 vjet me radhë, ajo u ruajt nëpërmjet këngëve të tyre pasi shqipja deri vonë nuk shkruhej, u ruajt duke e mbajtur gjallë gjuhën e arbit, duke folur me njëri-tjetrin, duke ju treguar fëmijëve të tyre për **Arbërinë**-veandin e largët për të cilin me aq mall flasin.

Kur je midis tyre është njësoj si të kthehesh 500 vjet në kohë, dëgjon gjuhën e arbit siç flitej para 500 vjetësh me disa ndryshime dhe deformime të cilët i përkasin dhe fajësojnë kohën e gjatë që ka kaluar por megjithatë ajo ekziston, e

pastër arbërore, dhe tepër origjinale e vjen të na rrëfej shumë sekrete të historisë dhe të ekzistencës së popullit dhe të kulturës shqiptare.

### Trajtat arkaike të së folmes të Strigarit

Nga ana gjuhësore arbërishtja i përket dialektit të **toskërishtes jugore** dhe paraqet tipare të përbashkëta me dialektet e jugut (**Labëri, Çamëri**), por ruan disa trajta arkaike që gjenden në shkrimtarët e lashtë të Veriut. Në bashkësitë arbëreshe gjendet dygjuhësia me shumëgjuhësi shoqërore: *italishtja* (gjuha e lartë, kodi i përpunuar) përdoret në shkollë dhe në marrëdhëniet zyrtare, ndërsa *arbërishtja* (gjuha e ulët, e pashkruar, kodi i ngushtë) përdoret në mjedisin familjar dhe në marrëdhëniet informale.

Në shqiptimin e Strigarit dhe të pesë katundeve të tjera arbëreshe të afërta frymëtorja (fërkimorja glotidale e shurdhër) zëvendësohet nga fërkimorja prapaqellëzore e zëshme (**gh**). Përveç kësaj në katundin **Strigari** shqiptohet **Strighari**, dhe për të emërtuar vendësin u kalua nga **strigarjot- i** zanafillor në **strigajot-in** e sotëm. Veçanti të tjera të arbërishtes strigarjote janë edhe: mbaresat **-ën, -ës, -ër, -ët**, të cilat bëhen **-en, -es, -er, -et -es**; z-ja fundore në rrokje të patheksuara shurdhohet në **-s**; midis një emëroreje e një gjinoreje të shquara nuk vihet nija e përpame (praku deres); epiteza **-inj** e vetes së parë të tashmes thjeshtohet shpesh në **-i** (*hapi, qelli*); pjesoret e foljeve *bjer, nxjer, shqer, vjer, bënj e enj* janë përkatesisht *bjer, nxjer, shqer, vjer, bën e bjejtur*; në vend të diftongut të brendshëm **-ua-** dëgjohet **-ue-**; *vjersh* bëhet *vjesh*; *përpara* mund të rëgjohej në *p'para*. Kur dy emra të afërt dhe paralelë kërkojnë të njëjtën rasë, mbaresa e të parit mund të lihet jashtë. Kjo dukuri, e dëshmuar të shumtën e herëve në kallëzoren, në këngët popullore të Strigarit gjendet edhe në rasi të tjera (veçanërisht në dy tetërokësha të këndimit për dasmën: *motr' e kunatavet, për motravet e kunatavet; shok' e gjiitonavet, për shokavet e gjiitonavet*).

Për ne mjaft interesante na u duk edhe pohimi i prof. **Vinçenco Brunos**, i cili na tregoi se vetë kishte dëgjuar një plakë nga Strigari të përdor një numërim karakteristik që nuk haset në asnjë të folme. Përveç që përdorte format e vjetra **vagizemale** (njëzet, dyzet, trezet e katërzet), plaka ka përdorur edhe format si: *njëzet e gjysmë për 30; dyzet e gjysmë për 50* (d.m.th. dyzet + gjysma e 20, pra 10). Për fat të keq ai nuk kishte material të regjistruar për këtë dukuri.

### Busti i Zef Serembes para Bashkisë

Titulli më i madh lavdie për Strigarin është padyshim poeti **Zef Serembe** (ose **Zepë Serembi**, siç i thuan vendasit) (1844-1901), me poezitë popullore arbëreshe e të cilat mburret e tërë bashkësia arbëreshe, jo vetëm në dhjetëvjetëshat e fundit. Për nder të tij edhe sheshi kryesor i fshatit mban emrin dhe bustin e këtij poeti lirik. Serembeja paraqet një figurë origjinale dhe e ndërlikuar, që spikat në letërsinë tonë. Vepra e tij pasqyron atë etapë të Rilindjes kur lëvizja kombëtare kishte marrë hov, prandaj dhe tema patriotike merr nën penën



**Bashkia e Strigarit dhe busti i bronzit të Zef Serembes në sheshin e Lirisë (vepër e Odhise Paskalit, dhuratë e Republikës së Shqipërisë Bashkisë së Strigarit, 1983).**

e tij një tingëllim kushtues të hapur dhe aktual. Zef Serembeja lindi më 6 mars 1844. Personaliteti i Serembes si krijues u formua në vitet e zjarra të lëvizjes kombëtare italiane të viteve 1848-1860, ku i ati mori pjesë aktive, aq sa u dënua me vdekje në mungesë nga qeveria burbone dhe u detyrua të endej maleve si komit.



**Para bustit të Zef Serembes me një arbëresh**



Të gjitha mbishkrimet janë të shkruara në dy gjuhë (italisht - arbërisht).

Serembja u bë këngëtar i kësaj lëvizjeje, i shtyrë jo vetëm nga ndjenjat liridashëse, po edhe nga prirja për të parë tek ajo një shprehje të trimërisë së arbëreshëve dhe një shpresë për pjesëmarrjen e tyre të mëtejshme për çlirimin e atdheut të të parëve.

Serembja shëtiti nëpër fshatrat arbëreshe të Sicilisë e të Kalabrisë, i ra anëmbanë Italisë, duke u lidhur më tepër me zakonet, me folklorin, me të folmet e ndryshme të arbëreshëve, me ndjenjat dhe ëndërimet e tyre, me ndjenjën e madhe të çlirimit të atdheut të të parëve. Po nuk gjeti

mi të vështirë thuhet se poetit i humbi pjesa më e madhe e këtyre dorëshkrimeve.

Më 1883, Serembja botoi librin "Poezi italisht dhe këngë origjinale të përkthyer nga shqipja". Megjithëse vjershat italisht kishin të meta nga ana e formës dhe niveli i përkthimit në italisht të krijimeve shqip nuk qe i kënaqshëm, libri ngjalli entuziazëm në rrethet letrare të kohës. Duke mos mundur të duronte gjatë atmosferën mbytëse që sundonte në Italinë e Jugut edhe pas zhdukjes së tiranisë së Burbonëve, poeti u nis sërish për në Brazil dhe për në Amerikën e Jugut. Aty e mbyll krijimtarinë e tij letrare me dy poezi, që dëshmojnë se ai nuk e humbi kurrë shpresën të lëvizja kombëtare shqiptare. Natyrën e tij të ndjeshme e mposhtën fatkeqësitë e jetës. Më 1901 ai e mbylli jetën në San-Paolo të Brazilit, në një gjendje çmendurie.

### Strigari burim i rapsodëve popullor

Pa asnjë dyshim shumë këngë të trashëguara me gojë u humbën për gjithmonë, thonë përgjegjësit e sportelit gjuhësor shtojnë se, Strigari me shekuj ka qenë burim i rapsodëve popullor. Le të mendohet vetëm se rapsodi të shumta popullore iu rrëfyer De Radës pikërisht nga plaka strigarjote Tortoshëla.

Disa studies të rinjë kanë arritur pak a shumë të

shpëtojnë shumë rapsodi. Ndër ta do të përmendim: **Ornella Kampnaro** (1944) në punën e saj të diplomës (*S. Cosmo Albanese e i suoi canti popolari, referues*) prof. Giuseppe Valentini, Universiteti i Palermos, 1970, paraqit këngë që i kanë rrëfyer informatorë të shumtën e herëve në moshë të thyer, të lindur në dhjetëvjetëshat e fundit të shek. XIX. Përveç shumë vjershave, ajo ka meritën që shpëtoi gjashtë rapsodi, ndër të cilat një variant të rrallë o më mirë të pashoq të **Konstantinit të**

**voglit**, që bën që protagonistin të vdesë si rob lufte, pa u kthyer në atdhe m'u ditën e martesës së dytë të gruas.

**Maria Sposato** (1949) (*I canti popolari di S. Cosmo Albanese e di S. Giorgio Albanese*), punë diplome, Universiteti La Sapienza, Romë, 1974 - referues prof. Giuseppe Gradilone) pas pak vjetësh mblodhi edhe ajo këngë popullore që bëjnë të mundshme krahasime të dobishme.

Një tablo të realitetit të Strigarit, në të gjitha faqet e tij, në fillim të viteve 70 ka paraqitur **Renato Avato** (1946) (*Identità culturale di S. Costino Albanese*), punë diplome, Universiteti La Sapienza, Romë, 1973 - referues prof. Tullio Tentori) e të tjerë.

Sa i përket jetës kulturore në fshat ekzistojnë shoqëri të ndryshme. Nga viti 1971 deri në 1974, Rrethi kulturor J. De Rada (aktiv në vitet 1969-1985) botoi fletoren satirike **Arza**. Nga data 7.11.2001 vepron shoqata muzikore **Euterpe**, e cila, ndër të tjerat aktivitete, me mbështetjen e Bashkisë së Strigarit, organizon koncerte e kurse përsosurimi të lartë muzikor. Gjithashtu në Strigar ka selinë Fondacioni "**J. de Rada junior**", që lindi falë një trashëgimi të të nipit homonim të poetit.

(Vazhdon)



(Në numrin e ardhshëm:

"Maqi - atje ku lindi Jeronim de Rada")



Pamje nga Strigari

asgjëkund qetësinë e shpresuar. Gjurmë të thella të dhimbshme në shpirtin dhe krijimtarinë e poetit la dashuria e pafat për një fshat arbëreshe, që më vonë kishte emigruar në Brazil, ku edhe vdiq pas pak kohe. Dëshira për të parë varrin e kësaj vajze si dhe shpresa që të përmirësonte gjendjen e vet ekonomike, e bënë poetin të nisej më 1875 për në Brazil. Po edhe këtu Serembja u zhgënjye shpejt, sepse pa korrupsionin e thellë të oborrit, jetën e degjeneruar të aristokracisë braziliiane. Pa kaluar as një vit ai u kthye në Itali, duke pasur si pasuri të vetme një trashëgim dorëshkrimesh. Gjatë këtij udhëti-